

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70010-26-1726-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Prokurimi i shërbimeve themelore për objektet e spitalit pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Erik Shpk  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

L.Dardania Su 6/5 C1 nr.7  
(Adresa)

Prishtine 13000  
(Vendi) (Kodi postar)

045/293398   
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Gentrit Leku  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)  
eriku.shpk@gmail.com  
(Adresa elektronike)

08.06.2026  
(Data e parashtrimit të ankesës)

  
(Nënshkrimi dhe vlerë)  


\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datën 07.04.2026  
Hapja e ofetrave me datën 30.04.2026  
Vendmi i AK me datën 22.05.2026  
Kërkesa për qasje në dokumentet e ofertes me datën 26.05.2026  
Vendim për pastrim të ofertes me datën 26.05.2026  
Kërkesa për Rishqyrtim me datën 29.05.2026  
Vendimi për Kërkesën për Rishqyrtim me datën 29.05.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Ne rregull sipas kohës së parashikuar për hapjen e ofertave

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Sipas Legjislacionit ne fuqi per Prokurim Publik mbrenda afatit ligjor kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues Sptali Regjinal i Prizrenit me dt.29.05.2026.*

*Vendimin mbi refuzimin e kesja Kerkese eshte publikuar me dt.29.06.2026*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Sipas dispozitave ligjore të Lpp-së, përkatësisht nenit 108A dhe afateve ligjore të paragrafit 3.2 në bazë të së drejtës sonë paraqesim kërkesë për ri-shqyrtim baza ligjore:

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)

### Dispozitat e shkeluara të Lpp-së

Neni 4 Paragrafi. 1.26

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, par. 1, 2, 3, 4

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par. 2 dhe 4

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, par. 1, 1.1

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës par.7

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve par.10.2

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullorja per Prokurim Publikë 001/2022

Neni 38,38.1,38.3 dhe 38.5

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Në cilësinë e Grupit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik të zhvilluar nga autoriteti kontraktues, paraqesim këtë ankesë, duke kundërshtuar vendimin për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim dhe vlersojme se është marrë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Konsiderojmë se gjatë zhvillimit të procedurës janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e saj, duke cenuar interesin tonë të ligjshëm si ofertues.

Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka propozuar për dhënie të kontratës një Grup Ekonomik me çmim më të lartë se oferta jone pjesëmarrëse në procedurë, duke vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë economicitetin dhe trajtimin e barabartë.

Duke u nisur nga sa më sipër, ne paraqesim faktet dhe dëshmitë tona pranë Autoritetit Kontraktuesi si me poshtë:

### Argumenti 1

**Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të posedoj minimumin (5) punëtor të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë në përputhshmëri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanisë.**

**Dëshmia 4. Të dëshmohet me listë me kopje të certifikatave valide dhe organogrami i kompanisë (kopje). Çdo zbulim i informatave të rrejshme apo mashtruese AK do të vepron konform Nenit 99.2 të LPP-së.**

Ne dosjen e tenderit është kërkuar në mënyrë të qartë që Operatorët Ekonomik të paraqesin si dëshmi "organogrami e kompanisë" si element thelbësor për verifikimin e strukturës organizative, hierarkisë funksionale dhe kapaciteteve menaxheriale për realizimin e kontratës. Pavarësisht se kjo ka qenë kërkesë e drejtpërdrejtë e Dosjes së tenderit nuk ka ofruar asnjë dokument andaj ju nuk e përmbushni këtë kërkesë duke mos ofruar asnjë dëshmi përkatëse.

Neni 40.13 i Rregullores Nr.001/2022 -Komisioni Vlerdsues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënie të kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Duke iu përgjigjur Kërkesës nr. 4, ne si Grup Ekonomik kemi dorëzuar një listë në formë organogrami, ku janë të cekura shumë qartë numri i punëtorëve, emri, mbiemri, numri personal, profesioni dhe vendi i punës.

Të gjitha këto tregojnë qartë strukturën organizative, hierarkinë funksionale dhe kapacitetet menaxheriale për këtë aktivitet të prokurimit.

Vlerësojmë se në këtë mënyrë janë paraqitur qartë të gjitha elementet e kërkuara. Mirëpo, nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur vullnet që ta vlerësojë këtë tender në mënyrë të njëanshme dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të prokurimit publik, atëherë konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 38 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, përkatësisht nenet 38.1, 38.3 dhe 38.5.

**Konstatimi I AK ne Refuzimin e Kerkese per Rishqyrtim : Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe obligim ligjor që gjatë fazës së vlerësimit të verifikojë nëse dokumentet e dorëzuara përmbushin substancialisht kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk është i obliguar të pranojë dokumente të paplota apo vetëm formalisht të dorëzuara.**

Konsiderojmë se organogrami është dokument sqarues që nuk ndryshon përmbajtjen substanciale të ofertës dhe mund të kërkohej në kuadër të sqarimeve të ofertës, pa krijuar avantazh konkurrues apo pa ndryshuar gjendjen faktike të kapaciteteve të operatorit ekonomik në momentin e ofertimit.

## Argumenti 2

**Kërkesa 9. Operatori ekonomik duhet të plotësoj**  
• Makinë me ulëse me motor me gaz (LPG) për larjen dhe fshirjen e dyshemes, me kapacitet së paku 150L për ambiente të jashtme dhe të brendshme. Ta posedoj sistemin pastrim ekologjik pa detergjent (ec-H2O) 1 copë. • Kranë me lartësi deri në 25m, për përdorim të pastrimit të dritareve 1 copë.

**Dëshmia 9. Të dëshmohej me listë të paisjeve e nënshkruar dhe vulosur dhe dëshmi të tjera lidhur me kërkesat (kopje), Lista e pajisjeve për realizim të punëve të shërbimeve të pastrimit, kësaj liste duhet ti bashkangjiten dëshmi mbi pronësin e mjeteve. Listës duhet ti bashkangjiten, njëra nga këto dëshmi DUD doganore apo faturë për blerjen me transaksion bankar, mund të prezantoni kontrata mbi qiramarrjen (kopje) me dëshmitë përkatëse se i njëjti e ka në pronësi. Çdo zbulim i informatave të rrejshme apo mashtruese AK do të vepron konform Nenit 99.2 të LPP-së.**

**2. Ju keni paraqitur një listë të pajisjeve për të cilat keni pretenduar se i posedoni.**

**Për kërkesën lidhur me kranin me lartësi 25m, ju keni prezantuar: Një librezë për automjetin e identifikuar me emërtimin Mercedes-Benz Atego 815 me targa 01-795-UJ, ku është shënuar se bëhet fjalë për kamion me korpe me dy dyer.**

Për këtë automjet nuk keni ofruar dëshmi, specifikime teknike, certifikatë të prodhuesit apo ndonjë dokument tjetër verifikues për lartësinë e kranit (deri në 25m), siç kërkohet në DT, në mënyrë që të vërtetohet se pajisja i përmbush parametrat teknike të kërkuar. AK në dosjen e tenderit ka kërkuar që listës t'i bashkëngjiten dëshmi si: DUD doganor apo faturë për blerje me transaksion bankar, pasi që në këto dëshmi do të mund të shiheshin informatat lidhur me kërkesat tona, respektivisht nëse pajisja e kranit i ka këto parametra. Ndërsa ju keni ngarkuar vetëm librezën, në të cilën nuk shënohet se krani është 25m. Kurse lidhur me pajisjen "Makinë me ulëse me motor me gaz (LPG) me kapacitet 150L me sistem ekologjik pa detergjent (ec-H2O)", ju keni prezantuar:

Një "marrëveshje bashkëpunimi" me kompaninë N.T. "DAY STAR", sipas së cilës e njëjta pajisje ju jepet në shfrytëzim për këtë aktivitet të prokurimit. Ne kemi kërkuar të prezantoni kontratë qiraje dhe jo marrëveshje bashkëpunimi (përkrahje në dispozicion të kapaciteteve). Ju, në vend të kontratës së qirasë, keni paraqitur "marrëveshje bashkëpunimi" me kompaninë N.T. "DAY STAR", e cila: nuk përbën kontratë detyruese për qiramarrje, pasi nuk përcakton në mënyrë të qartë elementet esenciale si: kohëzgjatjen, ekskluzivitetin, obligimin e pandërprerë të furnizimit, përgjegjësinë për moszbatim apo penalitetet; nuk garanton disponueshmëri reale dhe të vazhdueshme të pajisjes, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues për realizimin e kontratës; ka karakter deklarativ dhe jo obligues juridikisht, duke lënë hapësirë për tërheqje apo mosrealizim pa pasoja kontraktuale të qarta.

Për më tepër, kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë specifike dhe e qartë për kontratë qiraje.

Duke u nisur nga pretendimet e Autoritetit Kontraktues, shihet qartë se ky pretendim nuk qëndron. Ne kemi dorëzuar një listë me mjetet e kërkuara dhe kësaj liste i kemi bashkëngjitur edhe dokumentacionin përkatës. Krani është në pronësi të kompanisë Schafberger Jr. GmbH dhe ne kemi dorëzuar librezën e regjistrimit, e cila dëshmon se krani është në pronësi të kompanisë. Sa i përket specifikimeve të tjera teknike, nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur interesim apo paqartësi lidhur me to, atëherë është dashur të kërkojë sqarime shtesë. Autoriteti Kontraktues ka përdorur standard të dyfishtë, duke kërkuar sqarime për makinën tek kompania "DAY STAR", në mënyrë që të zbërthejë marrëveshjen tonë dhe të gjejë ndonjë pikë për të na eliminuar me çdo kusht, ndërsa nuk ka kërkuar sqarime shtesë për kranin. Kjo është e papranueshme dhe joprofesionale, dhe shihet qartë se AK ka pasur si pikë reference Operatorin Ekonomik me çmim më të lartë për dhënien e kontratës, duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregulloret në fuqi.

### Argumenti 3

**Kërkesa 6. a) Operatori ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me vendim i cili ka përvoj pune min. 5 vite, që është i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, i njëjti duhet të jetë i certifikuar edhe për ndihmën e parë nga**

**Dëshmia 6. a) Të dëshmohet përvoja e punës me trust, CV, referencë, diploma e shkollimit, certifikata për shëndet dhe siguri në punë (kopje), certifikata e ndihmës parë (valide), certifikata; për pikën b) të dëshmohet përvoja e punës me trust, CV, referencë, diploma e shkollimit, certifikata**

<p><b>Kryqi i Kuq dhe menaxhim projekteve. b) një menaxher të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e riskut me certifikatë i cili ka përvojë pune min. 3 vite pas certifikimit, i cili do të monitoroj kualitetin e shërbimeve që ofrohen dhe të shqyrtoj dështimet apo mangësitë në ofrimin e këtyre shërbimeve të pastrimit.</b></p>	<p><b>përkatëse; vendimet për caktimin e menaxherëve me dëshmitë e kërkuara për këtë projekt. Çdo zbulim i informatave të rrejshme apo mashtruese AK do të vepron konform Nenit 99.2 të LPP-së.</b></p>
<p>Menaxheri i propozuar nga ana jonë posedon përvojë të konsiderueshme në menaxhimin dhe koordinimin e kontratave, gjë që dëshmon aftësinë reale profesionale për realizimin e suksesshëm të projektit. Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi që, në përputhje me nenin 72 të LPP-së dhe dispozitat për sqarime të dokumentacionit, të kërkojë sqarime apo plotësime shtesë lidhur me këtë çështje, sidomos duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një dokument që nuk ndikon në substancën e ofertës financiare apo teknike. Vlerësojmë se eliminimi për këtë arsye është joproportional dhe në kundërshtim me parimet e konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë, veçanërisht kur kapaciteti profesional i stafit tonë është dëshmuar përmes përvojës konkrete në realizimin e kontratave të ngjashme. Sa i përket certifikates menagjimit te Riskut te Menaxherit tonë,. Nga ky institucion kemi pranuar konfirmim zyrtar, siç dëshmohet në email-in bashkëngjitur, i cili vërteton vlefshmërinë dhe autenticitetin e certifikatës në fjalë.</p>	
<p>Theksojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit tonë, është mbështetur vetëm në një verifikim të brendshëm dhe të njëanshëm, pa ndërmarrë asnjë hap për të kërkuar sqarime shtesë nga ne si Operator Ekonomik, dhe as për të kontaktuar institucionet përkatëse që kanë lëshuar certifikatat relevante.</p>	
<p>Një qasje e tillë është në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, si dhe me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë procedurat e prokurimit publik. Mosverifikimi i drejtpërdrejtë pranë institucioneve lëshuese dhe moskërkimi i sqarimeve nga ana jonë ka rezultuar në një vlerësim të njëanshëm dhe jo të plotë të ofertës sonë. Për rrjedhojë, vlerësojmë se vendimi është mbështetur në supozime dhe interpretime të pabazuara, duke cenuar objektivitetin e procesit dhe duke krijuar perceptimin e një trajtimi jo të drejtë ndaj kompanisë sonë. Autoriteti Kontraktues, me ngulm të lartë, po kërkon që ne si Grup Ekonomik të na largojë nga konkurrenca, duke shpikur verifikime të njëanshme dhe duke tentuar të na dëmtojë. Kjo nuk është në frymën e një vlerësimi real dhe të mbështetur në parimet e Ligjit të Prokurimit Publik, por tenton të zvogëlojë konkurrencën dhe të veprojë në favor të Grupit Ekonomik të propozuar për kontratë.</p>	

Lind pyetja nëse Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime dhe verifikime të njëjta edhe për Operatorin Ekonomik të propozuar për kontratë? Këtë nuk e dimë, pasi neve nuk na është lejuar qasja në dokumentacion. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë një vendim në të cilin thuhet se Grupi Ekonomik e ka pastruar ofertën pasi ajo përmban sekret afarist, vendim ky i nxjerrë pas kërkesës sonë për qasje.

Mirëpo, ne dyshojmë se Autoriteti Kontraktues ka propozuar për dhënie të kontratës një Grup të Operatorëve Ekonomikë, ku njëri prej anëtarëve të grupit, nëse ka përdorur referencën e lëshuar nga **Prishtina Mall**, kemi indicie dhe verifikime se kjo referencë nuk është konfirmuar nga institucioni në fjalë si dokument i lëshuar prej tij..

Këtë dyshim e mbështesim në faktin se e njëjta referencë është verifikuar në kuadër të një procedure tjetër të prokurimit, ku pas verifikimit të bëra ka rezultuar se referenca në fjalë nuk është lëshuar nga institucioni i përmendur në të.

Prandaj, lusim ekspertin e Organit Shqyrtues dhe Komisionin për Shqyrtimin e kësaj ankese që, në rast se kjo referencë gjendet në dokumentacionin e kësaj lënde dhe është përdorur nga ndonjëri prej anëtarëve të këtij Grupi të Operatorëve Ekonomikë për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit, të bëhet verifikimi i plotë i autenticitetit të saj dhe, nëse konstatohet se dokumenti nuk është lëshuar nga institucioni përkatës, rasti të trajtohet në përputhje me nenin 92.2 të LPP-së dhe dispozitat e tjera relevante ligjore.

Të bashkëngjitur gjeni verifikimin përkatës, nga i cili rezulton se referenca e lartcekur nuk është konfirmuar si dokument i lëshuar nga institucioni në emër të të cilit është paraqitur.

#### Argumenti 4

**Kërkesa 8. a) Deklaratë me shkrim nga operatori ekonomik se do t'i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe të bashkangjet gjitha dëshmitë e kërkuara.**

**Dëshmia 8. Për pikat a) Të dëshmohen me dokument,deklaratë nga operatori ekonomik të cekurat (origjinal),**

**5.Ju nuk keni paraqitur dokumentet e kërkuara, të cilat është kërkuar të bashkëngjiten.**

**Në faqen nr. 22 të Dosjes së Tenderit, tek specifikimet teknike të detyrueshme, kemi kërkuar:“Gjithashtu, duhet të paraqiten dëshmi për trajnimet përkatëse profesionale të stafit në fushën e higjienës dhe mirëmbajtjes.”**

Pra, për stafin tuaj të paraqitur nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi lidhur me trajnimet e përfunduara dhe nuk keni prezantuar ndonjë certifikatë përkatëse të tyre.

**Po ashtu, në faqen nr. 30 të Dosjes së Tenderit, tek specifikimet teknike të detyrueshme, kemi kërkuar:**

**“5. Monitorimi dhe mbarëvajtja e aktivitetit.”**

Duke u nisur nga ajo që është deklaruar nga Autoriteti Kontraktues, ne mbesim të habitur se si një zyrë e prokurimit nxjerr një vlerësim të tillë, duke e ditur se specifikimet teknike hyjnë në zbatim gjatë implementimit të kontratës dhe se çdo kërkesë e përfshirë aty nuk përbën domosdoshmërisht dokument që duhet të dorëzohet në ofertë.

Specifikimet teknike të detyrueshme janë nga faqja 20 deri në faqen 32 dhe përmbajnë shumë kërkesa, të cilat Operatori Ekonomik zotohet përmes dokumenteve/deklaratave se do t'i përmbushë në rast se shpallet fitues.

Ju i jeni referuar dy pikave, konkretisht faqes 22 dhe faqes 30, pika të cilat flasin për trajnimet e stafit profesional në fushën e higjienës dhe mirëmbajtjes, si dhe për një dokument/listë të kontrolleve ditore për zyra, tualete, korridore etj.

Kjo është një kërkesë e paprecedentë, pasi që të dyja këto çështje hyjnë në fazën e implementimit të kontratës. Duke qenë se kontrata ka qenë e bazuar në orë dhe çmimi është përcaktuar për orë, ku nuk ka qenë i përcaktuar ndonjë numër i caktuar i punëtorëve, kjo kërkesë hyn në implementim dhe jo në fazën e vlerësimit të ofertës.

Këto kërkesa nuk janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe as në Kushtet e Veçanta. Gjithashtu, nuk është përcaktuar ndonjë numër minimal i trajnimeve të stafit, ndërsa shumë qartë në Dosjen e Tenderit është shkruar se lista për kontrolle hyn në përdorim gjatë implementimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë standarde të dyfishta, duke u munduar të imponojë kërkesa që nuk janë të qarta dhe precize lidhur me atë se çfarë kërkohet.

Ne, si Grup Ekonomik, kemi bashkëngjitur një dokument i cili përmbledh të gjitha specifikimet teknike të detyrueshme, duke deklaruar se do t'u përmbahemi dhe do t'i zbatojmë ato në rast se shpallemi fitues.

**Argumenti 5**

**Kërkesa 8. d) Operatori ekonomik duhet të ofroj analizën financiare të ofertës duke përfshirë kompensimet si pagat e punëtorëve në vlerën neto 456.50 €, pagesat e kontributeve pensionale, pagesat shtesë sipas Ligjit të**

**d) Analiza financiare duhet të ketë kujdes dhe të paraqitet me të gjitha elementet e kërkuara konform kërkesës, dhe duhet të përfshijë saktë vlerat. Çdo zbulim i informatave të rrejshme apo mashtruese AK do të vepron konform Nenit 99.2 të LPP-së.**

**Punës si orët e vikendeve, festave, tatimin e mbajtur në burim sipas shkallës tatimore dhe pagesën e pushimit vjetor.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë vërejtje lidhur me analizën financiare të Grupit tonë Ekonomik për pushimet vjetore, ndërrimin e natës, vikendet dhe fitimin e kompanisë.

Theksojmë se, në bazë të specifikimeve teknike, ne e kemi ndërtuar analizën tonë sipas legjislacionit në fuqi. Analiza financiare mund të formulohet në mënyra të ndryshme dhe metodologjia e saj nuk është unike. Analiza jonë është përgatitur nga ekspertë dhe është plotësisht e bazuar në legjislacionin në fuqi.

Sa i përket pushimeve vjetore, Autoriteti Kontraktues ka sqaruar vetëm çfarë parasheh ligji, por nuk e ka zbërthyer këtë në mjete monetare. Ne kemi llogaritur pushimet vjetore bazuar në numrin e punëtorëve dhe pagat e tyre, prandaj shihet qartë se Autoriteti Kontraktues ose nuk ka ditur ta zbërthejë analizën, ose është bazuar në përfundime që nuk përkojnë me një vlerësim të drejtë dhe korrekt.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka paraqitur vlerën monetare se sa i kushtojnë Grupit Ekonomik zëvendësimet gjatë pushimeve vjetore në baza mujore.

Vetë kërkesa e Autoritetit Kontraktues, ku thuhet se:

“Operatori ekonomik duhet të ofrojë analizën financiare të ofertës duke përfshirë kompensimet si pagat e punëtorëve në vlerën neto 456.50 €, pagesat e kontributeve pensionale, pagesat shtesë sipas Ligjit të Punës si orët e vikendeve, festave, tatimin e mbajtur në burim sipas shkallës tatimore dhe pagesën e pushimit vjetor”,

bie ndesh me deklaratimet e mëvonshme të AK-së, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar paga bruto, por paga neto plus pagesat e kontributeve, pagesat shtesë sipas ligjit dhe tatimin e mbajtur në burim sipas shkallës tatimore. Kjo mënyrë e llogaritjes në praktikë çon në kalkulimin e pagës bruto të një punëtori.

Analiza jonë është e qartë dhe precize, mirëpo Autoriteti Kontraktues është bazuar në një kalkulim i cili nuk ka qenë i qartë për ne. Ne kemi pasur një tabelë me orarin e ordinancave dhe kalkulimi është bërë mbi orarin e cekur dhe në bazë të planit të menaxhimit që kemi planifikuar të zbatojmë.

Duke marrë parasysh se oferta jonë është më e lirë vetëm për 268.97 € në muaj dhe 9,682.92 € në totalin e ofertës, atëherë shihet qartë se analiza financiare është llogaritur në bazë të specifikimeve teknike të ofruara për të gjitha kompanitë.

Gjithashtu, në një shtyllë të analizës kemi përfshirë edhe shërbimet me kran dhe shërbime të tjera.

Mosllogaritja e fitimit të kompanisë nuk është kriter për eliminim dhe as nuk ka qenë kërkesë e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, si dhe të nenit 56 lidhur me kriteret për dhënien e kontratës.

#### Argumenti 6

Dokumenti “Përshkrimi i Çmimit” i ngarkuar nga ana e AK-së në platformën e E-prokurimit për këtë procedurë është në formatin “Excel .xlsx”, ashtu siç përcaktohet në dispozitat ligjore 23.10 dhe 17.8 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku thuhet:

“Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorë vetëm Listën e Çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në formatin Excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik Dosja e Tenderit dhe Lista e Çmimeve publikohen si dokumente të ndara...”

Ju nuk e keni ngarkuar dokumentin “Përshkrimi i Çmimit” në formatin “Excel .xlsx” ashtu siç është përcaktuar. Ju e keni ngarkuar këtë dokument në formatin “.pdf”, duke modifikuar llojin e dokumentit nga “.xlsx” në “.pdf”.

**Asnjë ndërhyrje apo modifikim nuk lejohet nga ofertuesi.**

Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se ne nuk e kemi ngarkuar siç duhet Listën e Çmimeve, duke pretenduar se kemi ndërhyrë në dokument për shkak se “Përshkrimin e Çmimeve” e kemi dorëzuar në format PDF, të skanuar dhe të vulosur.

Ky qëndrim është i pavërtetë, i keqinterpretuar dhe i pabazuar në legjislacionin në fuqi.

Në fakt, dispozitat ligjore të cilave u referohet Autoriteti Kontraktues kanë të bëjnë me obligimet e vetë Autoritetit Kontraktues lidhur me mënyrën e publikimit dhe ngarkimit të Listës së Çmimeve për operatorët ekonomikë në platformën elektronike të prokurimit.

Askund nuk është e përcaktuar se skanimi i dokumentit në format PDF krijon problem apo përbën ndërhyrje të palejuar në dokument. Përkundrazi, skanimi, nënshkrimi dhe vulosja e dokumenteve përbëjnë një element sigurie dhe autenticiteti, duke garantuar se në ato lista nuk mund të bëhen ndërhyrje apo ndryshime të mëvonshme në çmime.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues ka bërë zbrëthime dhe kalkulime të çmimeve duke nxjerrë numra pas presjes dhjetore, të cilët nuk ekzistojnë fare në ofertën tonë financiare.

Prandaj, konsiderojmë se ky interpretim i Autoritetit Kontraktues është arbitrar, joprofesional dhe nuk mbështetet në asnjë dispozitë konkrete të Ligjit për Prokurimin Publik apo të Rregullores përkatëse.

Nenet të cilat i referohet AK:

7.8 Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në

formatin excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara.

23.10 Lista e çmimeve e standardizuar është një Listë e çmimeve që gjenerohet nga sistemi dhe përmbanë elemente të paracaktuara të Listës se çmimeve. Kjo Listë e çmimeve shkarkohet nga sistemi i prokurimit elektronik. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund të plotësohet direkt në formën e sistemit. Në rast se Lista e çmimeve përmbanë numër të konsideruar të pozicioneve dhe lista e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme, rekapitulime të pozicioneve) të AK, AK mund të krijoj një liste të re jo-standarde dhe e cila duhet të krijohet vetëm në formatin excel Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në një format të listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, me fusha të mbyllura të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për t'u plotësuar nga ofertuesit: - Çmim për njësi - Norma e TVSH-së - Emri i prodhuesit - Shënimi i ofertuesit

Këto janë dy nenet e cituara nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë lidhur me Listën e Çmimeve.

Askund në këto dispozita nuk përcaktohen obligime apo ndalesa për Operatorët Ekonomikë, pasi i gjithë materiali të cilit i referohet Autoriteti Kontraktues ka të bëjë ekskluzivisht me obligimet e vetë Autoritetit Kontraktues.

Në këtë rast, si përfundim i të gjithë kësaj ankese, konkludojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të ofertave, duke shpallur fituese një ofertë më të shtrenjtë se oferta jonë dhe duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik, rregulloret në fuqi, si dhe duke u bazuar në vlerësime të pabazuara dhe tendencioze.

Për këtë arsye, përmes kësaj ankese kërkojmë nga Organi Shqyrtues I Prokurimit që:

- ta kthejë lëndën në rivlerësim;
- dhe ti udhezoje AK që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për shpalljen e ofertës sonë si ofertë më e lirë dhe e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

<b>Të Konsiderueshme</b>
--------------------------

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*